

ASTARE



PRIMER D

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Transparente	Bidon 1 Kg	15-20 m ² /l

PËRSHKRIM

Primer për stabilizimin dhe përforcimin e suporteve me bazë çimento. Primer me dispersion ujqor i përbërë nga rezina akrilike për parapërgatitjen e suporteve me bazë çimento. Njëtrajtëson aftësinë thithëse të bazamenteve dhe rrit aftësinë ngjitëse të tyre.

FUSHA E APLIKIMIT

Për fiksimin dhe përforcimin e suporteve të vjetra dhe të reja me bazë çimento, betone dhe suva. I rekomandueshëm për stabilizimin e bazamenteve përpara aplikimit të autoniveluesit. Në ambiente të brendshme dhe të jashtme, ambiente industriale si dhe ambiente të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike ekstreme (ngricave dhe të nxehtit). Sipërfaqja para aplikimit të PRIMER-D duhet të jetë pa lagështi. PRIMER D hollon me ujë në varësi të përdorimit dhe të kërkesave teknike. Zakonisht përdoret sipas këtyre raporteve:

Për parapërgatitjen e suporteve të vjetra me pluhur: PRIMER D : Ujë, 1:1. Për parapërgatitjen e suporteve ku do të aplikohet Autoniveluesi, 1:2.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Transparente	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Paketimi: Bidon, 1 kg	Konsumi: 15-20m ² /Litër
Magazinimi: 12 muaj nga data e prodhimit.	Densiteti: 1.08
Koha e tharjes: 1-4 orë në bazë të temperaturës	pH: 7.75
Viskoziteti: 45 KU	

